

Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvillon workshop-in mbi javën e integritetit

Në datat 10.12 - 13.12.2024, në Kontrollin e Lartë të Shtetit, u zhvillua Workshop-i “Java e Integritetit” nën sloganin “Jo thjesht një javë...por një mënyrë të jetuari! Përqafojmë ndershmërinë, transparencën dhe përgjegjshmërinë, çdo ditë!”.



Aktivitetet e organizuara në kuadër të kësaj jave, theksuan rëndësinë e integritetit dhe etikës në aktivitetet tona profesionale, duke synuar një menaxhim cilësor dhe transparent të auditimeve. Gjatë kësaj jave, u trajtuan aspekte të ndryshme të etikës profesionale, standardeve ndërkombëtare dhe metodologjive të auditimit, duke diskutuar

mënyrat për t’u përmirësuar më tej dhe për të garantuar qëndrim të lartë ndaj kërkesave të integritetit në çdo fazë të auditimit. Pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime dhe aktivitete praktike, duke rritur kështu ndërgjegjësimin dhe aftësitë e nevojshme për të përballuar sfidat e përditshme të auditimit.

Fjala e hapjes u mbajt nga Sekretari Përgjithshëm, Znj. Valbona Gaxha, e cila foli mbi rëndësinë e integritetit në institucionet publike duke theksuar se është e rëndësishme të ndërtojmë besimin e palëve, nëpërmjet integritetit. Në vijim, u prezantua tema “Të ndërtosh një kulturë integriteti: Sfidat dhe mundësitë për audituesit” nga Znj. Miranda Misini, dhe më pas pjesëmarrësit u njohën me Kodin Etik të KLSH-së, prezantuar nga Znj. Ermira Hoxha. Dita e parë e aktivitetit u mbyll me diskutime dhe shpërndarje materialesh informuese për të



sensibilizuar më shumë stafin auditues mbi etikën dhe integritetin. Ditët në vijim u pasuan me aktivitete dhe prezantime si: tema “Rëndësia e integritetit – në fokus edhe institucionet publike” nga Znj. Elira Cukalla; “Etika profesionale dhe roli i audituesve në ruajtjen e integritetit” nga Z. Marlin Muça; “Rëndësia e integritetit – në fokus institucionet publike” nga Z. Blerin Shkurti, si dhe

“Shqyrtimi i praktikave të auditimit të integritetit dhe Standartet Ndërkombëtare” nga Znj. Xhuljeta Celaj dhe Znj. Anjeza Gjoci. Dita e fundit e aktivitetit u mbyll me diskutime dhe reflektime nga pjesëmarrësit.

Ky workshop, me pjesëmarrje të të gjithë stafit të KLSH-së, shërbeu si një praktikë e mirë për t'u angazhuar më thellë në përmirësimin e praktikave të auditimit dhe për të siguruar qëndrueshmëri të lartë ndaj kërkesave të integritetit.